



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 22 Akti

Nr. 54 Vendimi

Tiranë më 31.07.2018

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Xhensila Pine**

Kryesuese

**Valbona Sanxhaktari**

Relatore

**Etleda Çiftja**

Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatini, në Tiranë, më datë 30 korrik 2018, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Medi Bici**, gjyqtar në Gjykatën e Lartë, Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

**Ligji nr.84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr.49/2015** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

### **VËREN:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Medi Bici, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit është kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe, në bazë të nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ai iu nënshtrua procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar me shortin e hedhur në datën 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Relatore e çështjes u zgjodh me short znj. Valbona Sanxhaktari.

3. Me vendimin e datës 12.12.2017, trupi gjykues ka zgjedhur kryesuese për këtë çështje anëtarën znj. Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Branko Hrvatin.

4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD).

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillimin e hetimit administrativ.

4.1 ILDKPKI-ja, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konkluduar se:

- a. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b. Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c. Ka kryer fshehje të pasurisë;
- d. Ka kryer deklarim të rremë;
- e. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

4.2 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat

e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar, duke konkluduar mbi *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Medi Bici.”*

4.3 Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm e të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

5. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, e ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 25.06.2018, vendosi mbylljen e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Medi Bici, mbështetur në tri kriteret e vlerësimit. Njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, kalimin e barrës së provës për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën lidhur me rezultatet e hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit më datë 25.06.2018. Zotit Bici iu dhanë 15 ditë kohë për t'u njohur me dosjen, për të disponuar kopje të saj, si dhe për të paraqitur shpjegime ose prova të tjera për të provuar të kundërtën.

8. Subjekti i rivlerësimit e ushtroi të drejtën për t'u njohur me dosjen, ai paraqiti shpjegime lidhur me barrën e provës, si dhe prova të reja, brenda afatit të caktuar nga Komisioni.

9. Trupi gjykues, më datë 16.07.2018 vlerësoi se provat e paraqitura duhet të dorëzoheshin të noterizuara dhe ato që vinin nga shtetet e huaja duhet të ishin me vulën apostile. Për këtë vendosi t'i japë kohë subjektit për t'i paraqitur dokumentet në formën e kërkuar, duke e caktuar seancën dëgjimore për të në datën 30.07.2018.

10. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

11. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore të datës 30.07.2018, ora 10:00, me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 17.07.2018.

12. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 30.07.2018, ora 10:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

13. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë, ai dha disa shpjegime lidhur me hetimin e bërë kryesisht nga Komisioni, si dhe dokumentacionin dhe provat e paraqitura, ku mbështeteshin shpjegimet e tij, në formën e kërkuar nga Komisioni. Të gjitha provat i paraqiti

të noterizuara në përputhje të plotë me ligjin për noterinë në Republikën e Shqipërisë dhe të gjitha provat që janë marrë në Itali me vulë apostile dhe të nënshkruara. Krahas këtyre provave, subjekti paraqiti dhe 11 dokumente të reja dhe materialin shpjegues bashkangjitur.

14. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, si dhe provat e reja të paraqitura nga ai, vendosi t'i pranojë ato dhe t'i administrojë në dosjen e subjektit.

15. Në përfundim të seancës, subjekti i rivlerësimit kërkoi rikonfirmimin e tij në detyrë.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

16. Z. Medi Bici ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë kërkuar. Subjekti i rivlerësimit ka qenë i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

18. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, organe si: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, zyrat e

regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ALUIZNI, Qendra Kombëtare e Biznesit, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Drejtoria e Pastrimit të Parave, Ujësjellës-Kanalizime Tiranë, Universitetit “\*\*\*” dhe “\*\*\*” Tiranë dhe bankat e nivelit të dytë.

- c) Deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik, si dhe dokumentet ku mbështeteshin shpjegimet e tij.
- d) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si edhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht dhe në seancën dëgjimore.

20. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Medi Bici, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë.

21. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e tij të pasurisë për procesin e rivlerësimit, por edhe mbas verifikimit administrativ të kryer nga ILDKPKI-ja, si edhe Komisioni, rezulton se ka në pronësi pasuri të paluajtshme si vijon:

22. Pasuria truall, me sipërfaqe të përgjithshme 430 m<sup>2</sup>, krijuar nga sipërfaqja prej 193 m<sup>2</sup> e truallit të shtëpisë së vjetër, blerë në vitin 1986, e cila figuron në regjistrin hipotekor e regjistruar më 24.5.1995 dhe pjesa tjetër e truallit, prej 237 m<sup>2</sup>, është blerë me kontratë shitblerjeje më datë 15.01.1997, me çmimin prej 237.000 (dyqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekësh dhe regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit në regjistrin hipotekor më 16.01.1997.

22.1 Pasuria shtëpi banimi, në adresën Rr. “\*\*\*”, nr. \*\*\*, Tiranë. Kjo pronë figuron e regjistruar në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 2.7.2011, mbështetur në lejen e legalizimit nr. sh6467, datë 04.05.2011. Shtëpia është një vilë me 4 kate, e cila përbëhet nga garazhi, dy kate banesë dhe një papafingo. Shtëpia është ndërtuar në vitet 1993 - 1996, me vlerë të vetëdeklaruar nga subjekti prej 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë.

Burimi i krijimit të kësaj prone, sipas Deklaratës-Vetting: *Të ardhurat e krijuara nga puna në ish-minierën e qymyrgurit në Valias, Tiranë; të ardhurat e bashkëshortes, e cila ka punuar në ish-N.P.A nr. 2, Tiranë dhe ish-minierën e qymyrgurit në Valias, si dhe kontribut i vëllezërve.*

23. Sipas raportit të ILDKPKI-së, për këtë pasuri rezulton se:

*“Për sa i përket ndërtesës – godinë banimi në Rr. “\*\*\*”, Tiranë, ka deklarim të rremë ndërmjet deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në Deklaratën-Vetting dhe deklaratave të interesit të paraqitura ndër vite. Konkretisht, në deklaratën para fillimit të detyrës 2004 deri 2016-ën, subjekti ka deklaruar godinë banimi me dy kate, duke fshehur në këtë mënyrë sipërfaqen totale të ndërtimit dhe numrin e kateve.*

*Ndërtimi i paligjshëm i godinës së banimit bie ndesh jo vetëm me legjislacionin penal shqiptar (ndërtimi i paligjshëm parashikohet si vepër penale në nenin 199/a të Kodit Penal), por edhe me funksionin e subjektit, si dhe komprometon shumë rëndë figurën e tij si anëtar i Gjykatës së Lartë.*

*Në Deklaratën-Vetting, subjekti ka fshehur vlerën reale të investuar për ndërtimin e banesës (ka paraqitur vlerën e përlllogaritur nga ALUIZNI, rreth 10.000.000 lekë, deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës 6.000.000 lekë). Nuk ka justifikuar me dokumentacion ligjor burimin e krijimit (të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes deri në momentin e ndërtimit të kësaj banese), si dhe kontributin financiar të vëllezërve në ndërtim, çka e bën deklarinimin të rremë dhe me mungesë burimesh të ligjshme financiare.”*

### **Hetimi i kryer nga KPK**

24. Hetimi i kryer nga Komisioni kryesisht u shtri te mënyra e ndërtimit dhe fitimit të pronësisë së kësaj pasurie, si dhe burimi i krijimit të saj.

25. U verifikua vlefshmëria juridike e të gjitha akteve lidhur me fitimin e pronësisë së tokës, të cilat kanë sjellë pasojat juridike të fitimit të titullit të pronësisë, si dhe ndërtimi, legalizimi dhe regjistrimi në Hipotekë i ndërtesës.

26. U verifikua origjina e pronës te ZRPP-ja Tiranë dhe ALUIZNI.

27. Konstatohet se godina 4-katëshe e banimit është ndërtuar mbi një truall funksional me sipërfaqe 430 m<sup>2</sup>, i cili është regjistruar në Hipotekë dhe i konfirmuar nga ZRPP Tiranë. Ky truall është krijuar nga sipërfaqja prej 193 m<sup>2</sup> e truallit të shtëpisë së vjetër, blerë në vitin 1986, e cila figuron në regjistrin hipotekor e regjistruar më 24.05.1995, mbështetur në vendimin nr. 1809, datë 11.04.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pjesa tjetër e truallit, prej 237 m<sup>2</sup>, është blerë me kontratë shitblerjeje më datë 15.01.1997, me çmimin prej 237.000 (dyqind e tridhjetë e shtatë mijë) lekësh dhe e regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit në regjistrin hipotekor më 16.01.1997. Kjo pronë është blerë nga kufitarët, me të cilët z. Bici ka deklaruar se ka biseduar paraprakisht dhe ka filluar ndërtimin e shtëpisë. Pronarët e truallit (kufitarët) e kanë fituar atë me vendimin nr. 298, datë 15.08.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë. Ky vendim, nr. 298, datë 15.08.1995, i Komisionit të Kthimit të Pronave Tiranë është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive Tiranë, më tej pronarët e truallit kanë bërë një kontratë pjesëtimi vullnetar para noterit dhe më pas është realizuar kontrata e shitjes me z. Bici.

28. Aktualisht, sipërfaqja e truallit prej 430 m<sup>2</sup> figuron e regjistruar në regjistrin hipotekor në emër të z. Medi Bici.

29. Godina 4-katëshe e banimit është ndërtim pa leje i vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit si e ndërtuar në vitet 1993 - 1996. Ajo është vetëdeklaruar për legalizim më 07.02.2005, shoqëruar dhe me fotografitë e objektit (5 foto), që provojnë se ndërtesa ka qenë një godinë banimi e përbërë nga garazhi, dy kate banimi dhe një papafingo. Kjo banesë është legalizuar në vitin 2011. Ndërtimi i kësaj shtëpie banimi është realizuar nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe me ndihmën e familjarëve. Fillimisht ka qenë një shtëpi njëkatëshe ajo që ka shërbyer për banim deri rreth viteve 1993 dhe më pas është shembur ajo pjesërisht, duke u ndërtuar shtëpia e re vit pas viti.

30. Godina e banimit është legalizuar me lejen nr. \*\*\*, datë 04.05.2011, në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Medi Bici. Godina e banimit figuron e regjistruar në pronësi të Medi Bicit në regjistrin hipotekor me nr. \*\*\*, datë 22.07.2011.

31. Në Deklaratën e Pasurisë-Vetting, subjekti i rivlerësimit deklaroi si vlerë të godinës dhe truallit shumë prej 10.276.379 (dhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë, vlerë kjo e përlogaritur nga ALUIZNI Tiranë. Në të njëjtin kuadrat ku përshkruhet vlera me shifra dhe fjalë, subjekti i rivlerësimit sqaroi se përlogaritja e ALUIZNI-t është e gabuar, pasi është bërë 15 vjet pasi është ndërtuar godina e banimit, për të cilën thotë se ende është e papërfunduar.

32. Subjekti i rivlerësimit, në vitin 2003, në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie (dorëzuar në vitin 2004), përshkruan shtëpinë e banimit të përbërë nga dhomë e kuzhinë e ambiente ndihmëse në katin e parë dhe tri dhoma e ambiente ndihmëse në katin e dytë. Ai deklaroi se vlera e godinës së banimit është 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë dhe si burim vetëdeklaroi: *“Ndërtuar vetë në periudhën 1993 -1996 nga të ardhurat e mia dhe ndihma e katër vëllezërve, emigrantë në Itali.*

33. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të paraqitur shpjegime dhe prova për të argumentuar lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, si dhe konkluzionet e ILDKPKI-së.

34. Ai paraqiti shpjegimet e tij, ku, ndër të tjera, sqaroi:

*“Në vitin 1986, unë kam blerë një shtëpi në territorin e fermer “\*\*\*”. Kjo shtëpi ishte në një kulm me disa familje të tjera. Meqenëse ishim ngushtë për banim, pas vitit 1990 vendosëm të bënim një shtesë, se më parë nuk lejohesh, se aty kanë qenë dy shtëpi, një shtëpi që quhej shtëpia e \*\*\* dhe kjo shtëpia jonë kishte një emër të një doktori të famshëm, i cili ishte larguar nga aty nga viti 1960. Meqenëse filloi shkatërrimi, u prish ferma, filluan ndërtimet, të gjithë ndërtuan shtëpi dhe, pasi bisedova me pronarët e truallit, të cilëve nuk u ishte kthyer akoma toka, mendova të bëj një shtëpi, në oborrin e kësaj shtëpie. E filluam ndërtimin në vitin 1993 me materiale të bëra në vitin 1992 – ju kam paraqitur një kopje të librezës të të gjitha lekëve që kam pasur. Nuk ishin pak, ishte gati vlera e një shtëpie në atë kohë, janë blerë të gjitha materialet dhe ka zgjatur ndërtimi 3 vjet për arsye se, kur e bën vetë, mundësitë financiare janë të pakta, do presësh vit pas viti, punëtorinë do ta bësh vetë. Ky ndërtim ka dhomë e kuzhinë në katin e parë, dy dhoma e kuzhinë në kat të dytë. Të gjitha dhomat, asnjëra nuk është më e madhe se 4 x 3.5m, përveç kuzhina e katit të parë, garazhin e makinës poshtë dhe një ambient ku nderim rrobat në kulmin e çatisë, që i thonë papafingo, që nuk është më shumë se 20 m².”*

35. Lidhur me burimin e financimit për ndërtimin e kësaj godine banimi në vlerën prej 6.000.000 (gjashtë milionë) lekësh në vitet 1993 - 1996, subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumente justifikuese mbi të ardhurat e tij dhe të gruas së tij. Ai paraqiti edhe një librezë kursimi të asaj kohe (viti 1991), me kursimet e mbledhura nga paga.

35.1 Z. Bici ka deklaruar se:

*“Një kontribut shumë të madh në ndërtimin e banesës kanë dhënë edhe dy vëllezërit e mi, A. dhe Q.B, të cilët që nga viti 1993 jetojnë dhe banojnë në Itali në zonën e Breshias, dhe aktualisht ata kanë edhe shtetësinë italiane. Për dërgesat e tyre nuk kam mbajtur ndonjë dokument, pasi sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë për marrëdhëniet juridike ndërmjet të afërmeve, dhe sidomos ndërmjet vëllezërve dhe motrave, nuk kërkohet forma shkresore.*

*Në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 01.07.2018, të bërë përpara noterit B.S. L, vëllai A.B deklaroi se: Unë dhe vëllai tjetër, Q, kemi shkuar në Itali si klandestinë në vitin 1993 dhe deri në vitin 1995 kemi punuar pa dokumente të rregullta. Më pas kemi marrë lejet e qëndrimit, duke jetuar dhe lëvizur normalisht. Ai deklaroi se, bashkë me vëllanë tjetër, Q, më kanë*

*ndihmuar në vitet 1993, 1994, 1995 dhe 1996, duke dërguar nga Italia edhe dokumentet zyrtare që tregojnë burimet financiare të tyre, që janë “Cudet” (përmbledhëset e pagave), ose “busta pagat” (listëpagesat). Këto akte provojë faktet se, në periudhën që është ndërtuar shtëpia, dy vëllezërit e mi kanë qenë emigrantë ekonomikë.”*

36. Pas analizës së thelluar ekonomike, konstatohet se vlera e kursyer përputhet me të ardhurat e siguruara ndër vite, duke u klasifikuar si burim i ligjshëm, pasi subjekti i rivlerësimit ka provuar origjinën, si dhe e ka shoqëruar me dokumente.

36.1 Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe dokumente me vulë apostile lidhur me të ardhurat e vëllezërve ndër vite në shtetin italian.

37. Tokë arë, me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup>, në \*\*\*-Durrës, përfituar me aktin e marrjes së tokës në pronësi më datë 05.12.1994, regjistruar më 24.12.2010.

38. Burimi i krijimit, sipas Deklaratës-Vetting: *Ligji nr. 7501, i vitit 1991.*

39. Hetimi i kryer nga Komisioni: ZVRPP Durrës ka konfirmuar pronësinë e tokës në emër të subjektit, regjistruar në bazë të ligjit nr. 7501, të vitit 1991.

40. Autoveturë “Daimler Chrystler”, prodhim i vitit 2003, me targa \*\*\*, e blerë me kontratën nr. \*\*, datë 13.08.2010. Automjeti është blerë për 10.000 (dhjetë mijë) euro nga shtetasi P.K.

41. Burimi i krijimit, sipas Deklaratës-Vetting: *500.000 (pesëqind mijë) lekë nga shitja e automjetit të mëparshëm dhe pjesa tjetër nga kursime familjare.*

42. Hetimi i kryer nga Komisioni: Autovetura “Daimler Chrystler”, prodhim i vitit 2003, blerë më datë 13.08.2010, për vlerën 10.000 (dhjetë mijë) euro nga shtetasi P.K. Subjekti i rivlerësimit ka blerë këtë autoveturë pasi ka shitur automjetin “Mercedes - Benz”, tip 190 D, me çmim 500.000 lekë, më datë 08.01.2010, vërtetuar nga noteri D.M, me vërtetimin nr. \*\*\* rep., me palë shitëse Medi Bici dhe palë blerëse R.R dhe pjesën tjetër të shumës e ka plotësuar nga kursimet familjare.

43. Përputhet deklarata e subjektit me të dhënat e dërguara nga DRTRRSH-ja.

44. Rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare për këtë blerje.

45. Shkollim i fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, z. Medi Bici:

- Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.01.2018, Universiteti “\*\*\*” na informon se pagesat e kryera për studentin M.B, për vitet 2008 - 2011, janë 9.500 (nëntë mijë e pesëqind) euro.
- Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.02.2018, Universiteti “\*\*\*” na informon se pagesat e kryera për studentin E.B, për vitet 2010 - 2016, janë 21.154 (njëzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) euro.

46. Ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vëllai i tij, I.B., me banim në Itali, ka financuar dhe e ka mbështetur atë për pagesën e një pjese të studimeve të dy djemve të tij, me një shumë totale 10 mijë euro, të ndara në vite: në vitin 2008 – shuma prej 2000 eurosh; në vitin 2009 – shuma prej 3000 eurosh; në vitin 2010 – shuma prej 3000 eurosh; në vitin 2012 –



shuma prej 2000 eurosh. Për këtë ai ka paraqitur edhe një deklaratë të vëllait të tij, i cili konfirmon dhënien e kësaj ndihme në formën e dhuratës për vëllain e tij.

47. I pyetur mbi mundësitë financiare të vëllait të tij për mbulimin e kësaj shume parash, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar:

*“Në vitin 2008, djali i madh E. B mbaroi shkollën e mesme dhe vëllai këmbëngulte që ta dërgoja për studime tek ai në Itali, por meqenëse universiteti ishte larg vendit ku banonte vëllai dhe udhëtimi bëhej me anë të një treni lokal dhe më pas me autobus deri në qytetin e Breshias, Itali, vendosa që ta regjistroj në shkollën e lartë jopublike “\*\*\*” Tiranë, e cila ishte me pagesë, një pjesë të cilës e mori përsipër ta paguante vëllai, i cili në kohën kur vinte me pushime më ka dhënë: Për vitin 2008 shumën 2.000 euro dhe në vitin 2009 shumën 3.000 euro.*

*Në vitin 2010 filloi studimet e larta në Universitetin e \*\*\*në Tiranë edhe djali tjetër, M., dhe vëllai për vitin 2010 më ka dhënë shumën 3.000 euro, ndërsa për vitin 2012 shumën 2.000 euro. Për këto pagesa nuk kemi bërë dokumente, pasi e kam thënë edhe më sipër që Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë në rastin marrëdhënieve civile ndërmjet të afërmeve, dhe sidomos ndërmjet vëllezërve dhe motrave, nuk e kërkon formën shkresore.*

*Pas deklarimeve që kam bërë në ILDKPKI më datë 07.04.2016, vëllai më dërgoi nga Italia deklaratën e datës 10.06.2016, në të cilën ai deklaronte që ato që kisha thënë ishin të vërteta. Dua të theksoj që kjo deklaratë nuk është një dokument i thjeshtë i paraqitur nga një person fizik, sepse ajo mban vulën e një shoqërie të huaj, prandaj ajo duhej konsideruar si një dokument i lëshuar nga një shoqëri e së drejtës tregtare ndërkombëtare dhe ka fuqi të plotë provuese.”*

48. Për të provuar mundësitë financiare të vëllait I.B., subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të ardhurat e tij në shtetin italian, duke paraqitur dokumentin fiskal të rrogës, pagesën e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore, (bustapaga) për të provuar të ardhurat e vëllait I.B. Këto dokumente janë paraqitur me vula apostile.

49. Gjendje në llogarinë bankare në lek, në “Credins Bank”, në emër të Medi Bicit.

50. Hetimi i kryer nga Komisioni: “Credins Bank” ka konfirmuar llogarinë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje 1.814.618 (një milion e tetëqind e katërbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë më datë 09.01.2017. Kjo llogari kreditohet nga paga e subjektit.

51. Nga verifikimi i *statement*-it të dërguar nga “Credins Bank”, rezulton se subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e tij.

52. Gjendje në llogarinë bankare në lek, në “Raiffeisen Bank”, në emër të Medi Bicit.

53. Hetimi i kryer nga Komisioni: “Raiffeisen Bank” ka konfirmuar llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit me gjendje prej 245 (dyqind e dyzet e pesë) lekë më datë 10.01.2017. Kjo llogari kreditohet nga paga e subjektit deri në vitin 2016.

54. Nga verifikimi i *statement*-it të dërguar nga “Raiffeisen Bank”, rezulton se subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e tij.

55. Hetimi administrativ kryesisht i kryer nga Komisioni u shtri edhe më tej nga ai i deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit.

56. Për këtë është kërkuar informacion nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ALUIZNI, Qendra Kombëtare e Biznesit, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Drejtoria e Pastrimit të Parave, Ujësjellës-Kanalizime Tiranë.

57. Nuk rezulton nga ndonjë burim që ky subjekt të ketë pasuri të paluajtshme, të fshehura apo të padeklaruara, të mbajtura nga persona të tjerë.

58. Subjektit të rivlerësimit iu dërgua nëpërmjet adresës zyrtare të *e-mail*-it edhe një pyetësor-tip dhe nga përgjigjet e këtij pyetësoi, deklaratimet ishin korrekte dhe në përputhje me deklaratimet ndër vite të subjektit të rivlerësimit.

59. Subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij nuk kanë kryer udhëtime jashtë vendit, përveç disa vizitave ditore të z. Bici me fëmijët në Maqedoni, Kosovë e Mal të Zi.

### **Konkluzione lidhur me vlerësimin e pasurisë.**

60. Subjekti i rivlerësimit ka në pronësi si pasuri të paluajtshme një shtëpi banimi dhe truallin. Shtëpia e banimit është ndërtuar pa leje mbi truallin e blerë prej tij. Ndërtimi pa leje mund të konsiderohet si pasojë e mosveprimit në kohë të organeve kompetente për miratimin e lejeve zhvillimore përkatëse. Fillimisht ligji nr. 7693, datë 6.4.1993, “Për urbanistikën”, e ka parashikuar ndërtimin pa leje si kundërvajtje administrative, që për pasojë sanksionohet me gjobë. Ndërsa edhe më vonë, ligji nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, u vijua me të njëjtin qëndrim, por për herë të parë u parashikua legalizimi i ndërtimeve pa leje, *kryesisht i ndërtimeve të kryera pa leje nga pronarët në pronat e tyre*, ku sipas nenit 77, KRRT duhej të vendoste legalizimin e ndërtimit, me kushtin e shlyerjes së detyrimit nga ndërtuesi.

61. Me miratimin e ligjit nr.7895, datë 27.1.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në seksionin XI parashikohen veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës si “shpërdorimi i tokës” dhe “pushtimi i tokës”. Në këtë periudhë ende nuk ishte parashikuar figura e veprës penale të ndërtimit të paligjshëm. Vetëm në vitin 2008, nisur nga domosdoshmëria e ndërhyrjes në nivel të legjislacionit penal, në kushtet e përballjes me një situatë alarmante ndërtimesh pa leje në territor, situatë e cila cenonte haptazi zhvillimin e territorit, u bënë amendimet e Kodit Penal, duke parashikuar për herë të parë ndërtimin pa leje, si figurë më vete dhe konkretisht neni 199/a i ligjit nr. 10023, datë 27.11.2008, parashikonte se: *“Ndërtimi i paligjshëm i një objekti në tokën e vet dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Por kjo vepër e kryer në tokë publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në 5 vjet.”*

62. Po ashtu, vërehet se subjekti i rivlerësimit ka këtë pasuri të paluajtshme, shtëpi banimi dhe truall, qysh prej ndërtimit të saj, herët në vitet 1996, dhe deri në ditët e sotme pasuria e tij nuk është shtuar apo përmirësuar. Ajo ka qenë konstante qysh prej fillimit të punës së tij si gjyqtar në vitet 1994.

63. Po ashtu, lidhur me kostot e ndërtimit të banesës dhe burimit të ligjshëm të të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, referuar koston së përcaktuar nga ALUIZNI në momentin e legalizimit të objektit, ajo është kosto e përlllogaritur nga ALUIZNI në momentin e legalizimit, në vitin 2011, e cila sigurisht që është më e lartë se ajo e ndërtimit në vitet 1993 - 96, pasi është kosto e rivlerësuar me çmimet e tregut në atë vit. Kostoja e përcaktuar nga ALUIZNI në momentin e legalizimit, në fakt, nuk është kostoja reale e objektit, por është e bazuar në koston mesatare të ndërtimit të banesave për metër katror, bazuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, miratuar

në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 34/1 të ligjit nr. 9232/2004, të ndryshuar, mbi të cilin ALUIZNI kryen përlogaritjen duke verifikuar vetëm sipërfaqen e ndërtimit dhe duke e shumëzuar me 0.5 % (taksa e infrastrukturës) dhe me vlerën standarde të kostos mesatare të ndërtimit. Pra është një çmim fiks që i referohet vitit të legalizimit, pavarësisht nga kostoja reale e ndërtimit dhe që shërben për përcaktimin e taksës për infrastrukturën.

64. Subjekti i rivlerësimit në momentin e deklarimit të kësaj prone si pasuri të paluajtshme të regjistruar në regjistrat hipotekorë, deklaroi çmimin e kohës (çmimin e rivlerësuar). Ndërsa në deklarimin fillestar të pasurisë (për herë të parë) në vitin 2004, ai ka deklaruar çmimin prej 6.000.000 (gjashtë milionë) lekësh, që i referohet edhe kostos reale të ndërtimit të kësaj prone.

65. Pasaktësitë e subjektit të rivlerësimit në deklarimin ndër vite lidhur me sipërfaqen totale të banesës duket se nuk janë të qëllimshme dhe ato janë deklaruar të sakta në vitin 2011 (deklaruar në deklarimin vjetor 2012) kur edhe është bërë legalizimi dhe regjistrimi i kësaj pasurie të paluajtshme, po ashtu edhe në Deklaratën - Vetting. Ndërkohë, edhe nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, duket se sipërfaqja e padeklaruar në vitin 2004 (deklarimin fillestar) është ajo e një garazhi/bodrum, i cili në çdo rast nuk mund të jetë ndërtuar në një kohë të mëvonshme dhe i një sipërfaqeje prej 20 m<sup>2</sup> papafingo, e cila nga të gjitha informacionet e mbledhura nga Komisioni ka rezultuar si pjesë e banesës, të paktën që në momentin e deklarimit të saj për herë të parë për legalizim.

66. Financimi nga vëllezërit e subjektit të rivlerësimit të një pjese të ndërtimit të shtëpisë, si dhe një pjese të studimeve për dy djemtë e tij duket se është i justifikuar, për të gjitha argumentet e paraqitura më lart.

67. Ndërtimi i paligjshëm i godinës së banimit nuk bie ndesh me legjislacionin penal shqiptar në kohën e ndërtimit dhe se subjekti i rivlerësimit ka ndërtuar një shtëpi banimi në një sipërfaqe trualli të blerë dhe për banim familjar, për të cilën legjislacioni penal në fuqi në kohën e ndërtimit nuk ka qenë rëndues dhe as penalizues.

68. Rezultatet e paraqitura nga ILDKPKI-ja nuk qëndrojnë, ndërsa trupi gjykues konstaton se: deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; subjekti ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; ai nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë; subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

70. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar një raportin nr. 12110 prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar “*Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Medi Bici*”. Ky raport është i deklasifikuar.

71. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

## **Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës**

72. Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

73. Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës së gjyqtarit.

## **C. VERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

74. Raporti për analizën e aftësive profesionale i kryer nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është bazuar te:

- Formulari i vetëdeklarimit, 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosjet gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

### **Aftësitë profesionale**

#### **a) Njohuritë ligjore**

75. Subjekti i rivlerësimit, z. Medi Bici, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste, ai e analizon normën administrative e civile të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me norma kushtetuese apo të KEDNj-së. Në gjykimin penal, i kushton rëndësi çdo elementi të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale relevante. U kushton rëndësi rasteve kur evidentohen pjesë të ndryshme të legjislacionit për të identifikuar se cila prej tyre duhet të aplikohet, duke analizuar konfliktin e normave në raport me natyrën e mosmarrëveshjes. Në kuadër të respektimit të procesit të rregullt ligjor, si detyrim që rrjedh nga e drejta kushtetuese dhe KEDNJ, analizon detyrimin e organit të administratës publike që ka nxjerrë aktin për të njoftuar palët e interesuara për përmbajtjen. Kur është rasti, në funksion të nxjerrjes së konkluzioneve për zbatimin e ligjit, ai përdor referenca në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me zbatimin e hierarkisë së normave ligjore. Evidenton natyrën e mosmarrëveshjes dhe gjykatën kompetente. Një rëndësi të veçantë u kushtohet dhe respektimit ose jo të dispozitave procedurale nga gjykatat më të ulëta, kryesisht lidhur me kompetencën lëndore të tyre.

#### **b) Arsyetimi ligjor**

76. Subjekti i rivlerësimit, z. Medi Bici, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij, përfshi edhe mendimet e pakicës, janë të qarta dhe të kuptueshme. U kushton rëndësi edhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat paraqiten me strukturë të njëjtë me atë të vendimeve përfundimtare.

77. Struktura e vendimeve përfundimtare është e standardizuar dhe respekton kërkesat e legjislacionit procedural. Struktura e vendimeve është e qëndrueshme dhe e mirorganizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Respekton në shkallën e duhur rregullat e drejtshkrimit. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve të mosmarrëveshjes (shkaqeve të ngritura në rekurs) dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushtohet rëndësi analizës së normës ligjore në raport me faktet e konstatuara. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Madje, ai arsyeton në mënyrë të plotë edhe vendimet për mospranimin e rekursit. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga Gjykata Kushtetuese për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

### **Aftësitë organizative**

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

78. Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në përbërje të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

79. Lidhur me detyrën e gjyqtarit, ai ka deklaruar se në periudhën 01.01.2013 - 08.10.2016 i janë caktuar për gjykim 1780 çështje gjyqësore dhe ka përfunduar 1616 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 90.7 %. Në dokumentwt shtesë, ai ka paraqitur se për vitin e plotë kalendarik 2016 i janë caktuar 523 çështje, ka përfunduar 472 çështje si relator dhe ka mbartur 919 çështje. Pra, për periudhën 01.01.2013 - 31.12.2016 i janë caktuar 1928 çështje gjyqësore dhe ka përfunduar 1730 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 89.7 %.

80. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Lartë për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, gjyqtari Medi Bici ka përfunduar gjithsej 1326 çështje gjyqësore, nga të cilat 4 çështje penale, 217 çështje civile dhe 1105 çështje administrative.

81. Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Medi Bici ka qenë në intervale kohore nga 1 muaj e 11 ditë (*shih dosjen nr. 3*) deri në 2 vjet 9 muaj e 25 ditë. Nga këto, 4 çështje janë gjykuar tej afatit ligjor të parashikuar në ligjin e posaçëm, ndërsa një çështje është gjykuar brenda standardit kohor “brenda 90 ditëve nga depozitimi i rekursit në Gjykatën e Lartë” i përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012. Për çështjen që i përket *dosjes nr. 1*, afati nga data kur është marrë vendimi për caktimin e seancës gjyqësore më datë 18.02.2016 deri në datën 10.03.2016 është 20 ditë. Për *dosjen nr. 2*, afati nga data kur është marrë vendimi për caktimin e seancës gjyqësore më datë 28.11.2014 deri në datën 18.12.2014 është 20 ditë. Për *dosjen nr. 3*, afati nga data kur është marrë vendimi për caktimin e seancës gjyqësore më datë 22.06.2016 deri në datën 13.07.2016 është 21 ditë. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit, prej 2 vjetësh, 9 muajsh e 25 ditësh, ka qenë çështje themeli dhe në përfundim është disponuar me vendim themeli, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në pakicë.

82. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimet e 5 dosjeve të shortuara, rezultoi se arsyetimi i vendimeve është kryer në interval kohor nga 15 ditë gjer në 2 muaj e 18 ditë. Megjithatë, në këtë çështje, subjekti i rivlerësimit, ka dalë me mendim në

pakicë, ndaj ky afat nuk i referohet drejtpërdrejt atij. Në këto kushte, afati më i gjatë është 1 muaj e 1 ditë – *dosja nr. 1*. Ndër 5 dosje të vëzhguara, 4 vendime janë arsyetuar jashtë afatit ligjor të parashikuar në ligjin e posaçëm, ndërsa një vendim është mendimi i pakicës. Vendimi që është arsyetuar me vonesën më të lartë prej 1 muaji e 1 dite ka qenë çështje me të cilën është disponuar me vendim themeli me të cilin është prishur vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin për rishqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit si gjykatë kompetente.

83. Vlen të theksohet se në të 5 rastet, vonesa ka pasur edhe nga anëtarët e trupit gjykues në nënshkrimin e vendimeve gjyqësore të arsyetuara nga relatori Medi Bici.

84. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Medi Bici, është eficient dhe efektiv. Ai i kushton rëndësi kohës, si një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Në efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së tij ka ndikuar ngarkesa sasiore. Në shumicën e rasteve, afatet ligjore të gjykimit janë tejkaluar. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit duhet të ketë një bashkëveprim më të mirë me anëtarët e Kolegjit për të shmangur vonesat prej tyre në nënshkrimin e vendimeve përfundimtare.

#### b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

85. Subjekti i rivlerësimit, Medi Bici, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Në 5 dosjet e vëzhguara u konstatua se gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë në 4 raste, të cilat kanë qenë produktive. Nga këto, për tri çështje subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendim për caktimin e seancës në dhomë këshillimi. Për sa i përket *dosjes nr. 5*, në dosjen gjyqësore nuk ka akte që dokumentojnë caktimin e seancës nga relatori, por rezulton se seanca është zhvilluar në datën dhe orën e planifikuar me procesverbal, sipas parashikimeve të nenit 61 të ligjit nr. 49/2012 dhe dispozitave procedurale. *Dosja nr. 4* është zhvilluar me dy seanca, të cilat kanë qenë produktive. Seanca është shtyrë për shpallje të vendimit në datën 25.02.2014, ora 11:00, ndërkohë që seanca e parë është e datës 11.02.2014. Pra, seanca është shtyrë pas 14 ditëve në shkelje të afatit 10-ditor të parashikuar nga neni 64/2 i ligjit nr. 49/2012. Ai ka kryer veprimet e nevojshme për caktimin e seancës gjyqësore, ka mbikëqyrur dokumentimin e veprimeve me procesverbal edhe në dhomë këshillimi, si dhe zhvillimin e gjykimit pa ndërprerje gjer në dhënien e vendimit përfundimtar.

#### c) Aftësia për të administruar dosjet

86. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se përgjithësisht ato kanë qenë të rregullta dhe të plota. Për veprimet e kryera është mbajtur procesverbal gjyqësor, edhe kur Kolegji ka proceduar në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e palëve. Në 4 prej dosjeve të vëzhguara mungon relatimi i ndihmësit ligjor. Në *dosjen nr. 5* gjendet relacioni i ndihmësit ligjor për dhomë këshillimi, ku është vendosur për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, por pa datë dhe nënshkrim të tij. Në 2 dosje mungon vendimi për caktimin e seancës gjyqësore. Në fashikull nuk përfshihen aktet e njoftimit të palëve (kopje të listave të gjykimit), por mjaftohet me relatimin e datës së shpalljes nga kryesuesi. Megjithatë, duhet evidentuar se në asnjë rast seanca nuk ka dështuar për shkak të njoftimeve të parregullta të palëve. Aktet e tjera të përfshira në dosje kanë qenë të sakta dhe në përputhje me kriteret e caktuara nga ligji.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### a) Etika në punë

87. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Medi Bici, konstatohet se në periudhën 20 shkurt 2004 - 7 korrik 2010, ai ka ushtruar detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Ndërsa për periudhën 7 korrik 2010 - aktualisht, ai ushtron detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, i emëruar nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. Nga vëzhgimi i 3 dokumenteve ligjore dhe i 5 dosjeve, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, z. Medi Bici, ushtron detyrën e gjyqtarit të Kolegjit Administrativ. Nuk ka të dhëna të tjera në lidhje me angazhimin dhe përgjegjshmërinë e subjektit në funksion.

b) Integriteti

88. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Medi Bici, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

89. Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Medi Bici. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

90. Duke përjashtuar mangësitë për shpejtësinë në gjykim dhe arsyetim, në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Medi Bici, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

a) Aftësitë e komunikimit

91. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, nuk ka të dhëna për mënyrën direkte të komunikimit të subjektit Medi Bici me palët ndërgjyqëse, pasi këto çështje janë shqyrtuar pa pjesëmarrjen e palëve dhe në asnjë rast subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë kryesues. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

92. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Medi Bici për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

93. Subjekti i rivlerësimit, z. Medi Bici, është angazhuar thellësisht në aktivitete profesionale. Ai i ka kushtuar rëndësi formimit akademik, ku konstatohet se pas marrjes së titullit "Jurist" në vitin 1994, ai ka marrë gradën shkencore "Master i nivelit të dytë" me medalje ari, në periudhën 2009 - 2010, për të vijuar më pas me gradën shkencore "Doktor" me vlerësimin shumë mirë në periudhën 2011 - 2016.

94. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka marrë pjesë në 9 trajnime dhe tryeza të rrumbullakëta, brenda periudhës së vlerësimit, si dhe në disa vizita studimore dhe zyrtare. Ai është autori i tri shkrimeve të botuara në revistën ndërkombëtare “Diskutime”, gusht 2014 Tetovë, Maqedoni; revistën “Jeta juridike” nr. 2/2015 dhe revistën “Studime juridike nr. 2/2015. Ka marrë pjesë në trajnimet e Shkollës së Magjistraturës të zhvilluara përpara periudhës së vlerësimit 2002 - 2010, kur ka qenë gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

95. Të dhëna nga burimet arkivore të KLD-së

Për subjektin e rivlerësimit, z. Medi Bici, nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLD-së për periudhën e vlerësimit, për shkak të detyrës që ai ka ushtruar në këtë periudhë.

96. Të dhëna nga burime arkivore të Ministrisë së Drejtësisë

Në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë ka një ankesë për subjektin Medi Bici nga shtetasi AJ, më 09.06.2014, për të cilën sektori i inspektimit dhe organizimit gjyqësor, pasi e shqyrtoi, u shpreh se nuk ka kompetencë të kontrollojë apo të veprojë në lidhje me dosjet që janë në shqyrtim gjyqësor pranë Gjykatës së Lartë.

97. Denoncimet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

Në vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Medi Bici, u morën në konsideratë edhe ankesat e subjekteve denoncues (13). Denoncimi i shtetasit V.Ç, denoncimi i shtetasit S.A, denoncimi i shtetasit N.D, denoncimi i shtetasit G.F, denoncimi i shtetasit P.B, denoncimi i shtetasit S.R, denoncimi i shtetasit SS, denoncimi i shtetasit A.Ç, denoncimi i shtetasit ESh, denoncimi i shtetasit R.R, denoncimi i shtetasit ES, denoncimi i shtetasit K.D dhe denoncimi i shtetasit F.P.

Ankesa 1.

Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 05.12.2017, shtetasi V.Ç akuzon subjektin e rivlerësimit për korrupsion pasi nuk ka marrë në shqyrtim çështjen e rikthyer në Gjykatën e Lartë nga Gjykata Kushtetuese, megjithëse ka kaluar një periudhë e gjatë kohore. Denoncuesi nuk paraqet fakte apo rrethana konkrete në lidhje me korrupsionin e dyshuar prej tij.

Ankesa 2.

Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 14.12.2017, shtetasi S.A akuzon subjektin e rivlerësimit për korrupsion, duke pretenduar se ai bashkë me dy anëtarë të trupit gjykues kanë pranuar ryshfet nga pronari i “\*\*\*\*” për të pezulluar ekzekutimin e një vendimi të konfirmuar dy herë rresht nga Gjykata e Apelit pa asnjë argument ligjor. Denoncuesi pretendon se vendimi për pezullim të ekzekutimit është marrë haptazi në mënyrë të paligjshme për shkak se janë të korruptuar, por pa dhënë detaje konkrete për fakte ose prova.

Ankesa 3.

Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 07.12.2017, shtetasi N.D pretendon se megjithëse çështja është regjistruar më 19.05.2014 në Gjykatën e Lartë, ende nuk është caktuar data e gjykimit dhe ka zvarritje në proces.

Ankesa 4.

Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 08.01.2018, shtetasi G.F pretendon se subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupit gjykues në Dhomën e Këshillimit të Gjykatës së Lartë që ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë pas pesë vjetësh që ky



vendim kishte marrë formën e prerë. Megjithëse nga të dyja palët është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, kjo gjë nuk është marrë parasys, sipas denoncuesit.

#### Ankesa 5.

Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 18.01.2018, shtetasi P.B pretendon se janë marrë vendime të njëanshme, duke mos u marr për bazë dokumentacioni ligjor i dalë nga zyrat e shtetit.

#### Ankesa 6.

Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 07.02.2018, shtetasi S.R pretendon se subjekti i rivlerësimit si anëtar i trupit gjykues që ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 01.12.2011, nuk ka respektuar vendimin nr. 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese.

#### Ankesa nr. 7

Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 08.02.2018, shtetasi S.S pretendon se subjekti i rivlerësimit, si anëtar i trupit gjykues, ka marrë një vendim abuziv kur ka vendosur pezullimin e ekzekutimit pa të drejtë në favor të “\*\*\*”.

#### Ankesa nr.8

Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 08.02.2018, shtetasi A.Ç pretendon se të gjithë trupat gjykues të shkallës së parë, të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë, ku bën pjesë dhe subjekti i rivlerësimit, kanë marrë vendime të padrejta në lidhje me çështjen, si edhe nuk zbardhin vendimin që jep mundësinë për të bërë ankim në Gjykatën Kushtetuese.

#### Ankesa 9.

Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 15.02.2018, shtetasi E.Sh pretendon se relatori, që është subjekti i rivlerësimit, ka marrë në shqyrtim, për moskalimin e çështjes për gjykim brenda një afati kohor prej tre muajsh, duke e shqyrtuar jashtë radhe. Sipas denoncuesit, ky fakt dëshmon për ndërhyrje dhe ndikim në punën e trupit gjykues, me qëllim orientimin e kësaj çështjeje sipas interesave të njëjës palë.

#### Ankesa 10.

Me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 01.06.2018, shtetasi R.R pretendon se subjekti i rivlerësimit ka qenë në trupën që ka vendosur mospranimin e rekursit në Gjykatën e Lartë, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë, duke pretenduar për një vendim të njëanshëm dhe jo të drejtë.

#### Ankesa 11.

Me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 14.06.2018, shtetasi E.S pretendon se trupi gjykues, ku bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit, nuk ka shqyrtuar dosjen gjyqësore, pasi në pjesën arsyetuese të vendimit janë shprehur se duhen dokumente shtesë lidhur me objektin e padisë, kur ndërkohë këto dokumente ndodhen në dosjen gjyqësore. Denoncuesi pretendon se trupi gjykues nuk ka zgjidhur konfliktin, por e kthen përsëri në gjendjen fillestare, për të zvarritur procesin.

#### Ankesa 12.

Me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 16.07.2018, shtetasi K.D kërkon shqyrtimin e vendimit nr.3, datë 24.11.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me të cilin 13 gjyqtarët tejkaluan caqet kushtetuese të padhunueshmërisë të së drejtës së ushtarakëve për masën e

pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke prekur vetë thelbin e funksionimit të shtetit të së drejtës.

Ankesa 13.

Me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 14.06.2018, shtetasi F.P pretendon se trupi gjykues, ku bën pjesë edhe subjekti i rivlerësimit, ka marrë vendim të padrejtë, në tejkallim të çdo afati ligjor dhe në shkelje të vazhdueshme të detyrës në shqyrtimin e çështjeve, ku denoncuesi ka qenë palë.

✓ Pas shqyrtimit të denoncimeve të paraqitura, nuk ka indice për të provuar pretendimet e ngritura.

98. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë këtë opinion lidhur me denoncimet e ardhura në Komision:

*“Gjatë karrierës sime të gjatë, në të gjitha shkallët e gjyqësorit kam shqyrtuar edhe mjaft çështje të vështira civile, të cilat kanë pasur lidhje me pronat, shoqëritë tregtare, largimet nga puna, etj. Gjithmonë jam munduar që të jem korrekt në kryerjen e detyrës, duke arsyetuar në një kohë sa më të shkurtër vendimet gjyqësore. Ka pasur raste që palëve nuk u pëlqejnë vendimet gjyqësore, por për një gjë ju siguroj se, të drejtën nuk e kam ndërruar dhe nuk do ta ndërroj me asgjë tjetër, sepse kam hyrë si idealist në sistemin e drejtësisë dhe i tillë dua të mbetem gjithmonë.*

*Nga studimi i dosjes më rezulton se një pjesë e ankimeve janë të kohëve të fundit dhe nuk kanë të bëjnë vetëm me mua. Kjo mënyrë ankimi ndaj vendimeve gjyqësore mua nuk më duket e drejtë, sepse për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave është e përcaktuar qartë në ligjin procedural penal dhe civil rruga që duhet të ndiqet nga ana e palëve ndërgjyqëse.”*

### **Konkluzione për vlerësimin e aftësive profesionale**

99. Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në (i) gjetjet e mësipërme dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në përfundim, relatori i çështjes propozoi për subjektin e rivlerësimit, z. Medi Bici: “I aftë”.

100. Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

## **V. KONKLuzioni Përfundimtar**

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale.

**PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

#### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Medi Bici, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Lartë, Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall më datë 31.07.2018, ora 14:45

#### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila Pine**  
**Kryesues**

**Valbona Sanxhaktari**  
**Relator**

**Etleda Çiftja**  
**Anëtar**

**Sekretare gjyqësore**  
**Anisa Duka**